

# KLAUZOLA KUNDËR KORRUPSIONIT E ICC-SË



## Çështjet kryesore

- Klauzolë që duhet të përfshihet në kontrata përmes së cilës palët angazhohen të respektojnë Rregulloren e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) për Luftën kundër Korrupsionit ose angazhohen të hartojnë dhe të mbajnë një program të përputhshmërisë me luftën kundër korrupsionit të korporatës
- Ndhomon në ruajtjen e besimit ndërmjet palëve dhe parandalon korrupsionin si në negociimin edhe në realizimin e kontratave



Përgatitur nga Komisioni i ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-korrupsionin dhe Komisioni për të Drejtën dhe Praktikën Tregtare



Versioni anglisht © 2012, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), Përkthimi në shqip © 2017, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC). Përkthyer në shqip nga ICC Albania me lejen e ICC.

ICC zotëron të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale për këtë vepër të përbashkët dhe nxit riprodhimin dhe shpërndarjen e saj, sipas kushteve më poshtë:

- ICC-ja duhet të citohet si burimi dhe zotëruesja e së drejtës së autorit, duke përmendur titullin e dokumentit © Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe vitin e publikimit nëse është e mundur.
- Duhet të merret leje e shprehur me shkrim për çdo ndryshim, përshtatje ose përkthim, për çdo përdorim tregtar dhe përdorim në ndonjë mënyrë që nënkupton se një organizatë ose person tjetër është burimi i veprës ose i lidhur me veprën.
- Vepra nuk mund të riprodhohet ose të vihet në dispozicion në faqet e internetit, përveç nëpërmjet një lidhjeje me faqen përkatëse të internetit të ICC-së (jo me vetë dokumentin).

Leja mund të kërkohet nga ICC-ja nëpërmjet adresës: [ipmanagement@iccwbo.org](mailto:ipmanagement@iccwbo.org).

Publikim i ICC-së Nr.740 E-Alb

## TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie .....	3
Shënim hyrës për zbatimin dhe qëllimin e përgjithshëm dhe strukturën e klauzolës .....	4
Klauzola kundër Korrupsionit e ICC-së .....	5
<b>A. Opsioni I: Përfshirja me anë të referencës e Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 .....</b>	<b>5</b>
Paragrafi 1 .....	5
Paragrafi 2 .....	5
Paragrafi 3 .....	5
Paragrafi 4 .....	5
<b>B. Opsioni II: Përfshirja e plotë e Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011.....</b>	<b>6</b>
Paragrafi 1 .....	6
Paragrafi 2 .....	6
Paragrafi 2.1 .....	6
Paragrafi 2.2 .....	7
Paragrafi 3 .....	7
Paragrafi 4 .....	7
<b>C. Opsioni III: Referenca e një programi të përputhshmërisë me luftën kundër korrupsionit të korporatës, siç përshkruhet në nenin 10 të Rregullores së vitit 2011 .....</b>	<b>8</b>
Paragrafi 1 .....	8
Paragrafi 2 .....	8
Paragrafi 3 .....	8
<b>Komentari për Klauzolën kundër Korrupsionit të ICC-së .....</b>	<b>9</b>
<b>Opsionet I dhe II .....</b>	<b>9</b>
<b>Paragrafi 1: Angazhimi kundër korrupsionit që mbulon periudhën para-kontraktuale.....</b>	<b>9</b>
1. Klauzola kundër Korrupsionit e ICC-së synon krijimin e besimit ndërmjet Palëve .....	9
2. Cilat janë Praktikat Korruptive që mbulon paragrafi 1? .....	9
3. A i referohet paragrafi 1 qoftë edhe avantazheve më të vogla të padrejta? .....	10
4. Cilat “masa të arsyeshme parandaluese” duhet të merren nga Palët në lidhje me ndërmjetësit e tyre?.....	10
5. Në cilat rrethana është i zbatueshëm angazhimi sipas paragrafit 1? .....	10
<b>Paragrafi 2: Angazhimi kundër korrupsionit që mbulon periudhën pas ekzekutimit të Kontratës (periudhat kontraktuale dhe post-kontraktuale).....</b>	<b>11</b>
1. Afati i angazhimit të Palëve kundër korrupsionit .....	11
2. Paragrafi 2 përmban një dispozitë për përfshirje ose me anë të referencës, ose në mënyrë të plotë.....	11
3. Karakteri i sipërmarrjes së Palëve.....	11
<b>Paragrafi 3: Mospërputhshmëria, masa korrigjuese dhe sanksione.....</b>	<b>11</b>
1. Mospërputhshmëria me Pjesën I të Rregullores së ICC-së .....	11
2. Masa korrigjuese të mundshme .....	12
3. Mbrojtja me anë të masave të përshtatshme parandaluese anti-korrupsion .....	12
4. Prova të mospërputhshmërisë .....	12
5. E drejta e auditimit.....	13
6. Sanksionet .....	13
<b>Paragrafi 4: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....</b>	<b>13</b>
<b>Opsioni III .....</b>	<b>14</b>
<b>Paragrafi 1: Programet e përputhshmërisë së korporatës .....</b>	<b>14</b>
1. Programet e përputhshmërisë së korporatës, siç përshkruhen në nenin 10 të Rregullores së ICC-së .....	14
2. Përgatitja e një programi të përputhshmërisë së korporatës .....	14
3. Caktimi i një përfaqësuesi të kualifikuar të korporatës .....	14
<b>Paragrafi 2: Të metat në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës, masat korrigjuese dhe sanksionet .....</b>	<b>14</b>
1. Të metat në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës .....	14
2. Masa korrigjuese .....	15
3. Komentari tjetër.....	15
<b>Paragrafi 3: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve .....</b>	<b>15</b>
<b>SHTOJCA I.....</b>	<b>16</b>
Pjesa I e Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit 2011 .....	16
<b>SHTOJCA II .....</b>	<b>18</b>
Neni 10 i Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit 2011 .....	18
Publikime të përzgjedhura të ICC-së .....	20

## Parathënie

### nga Jean-Guy Carrier, Sekretar i Përgjithshëm i ICC-së

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë ka përgatitur ndër vite një numër të madh klauzolash dhe model-kontrata. Këto dokumente pasqyrojnë praktikat më të mira ndërkombëtare të korporatës në veprimet me transaksionet, lehtësojnë negociatat e biznesit dhe përmirësojnë hartimin e dokumenteve të shumta kontraktuale që përpunojnë shoqëritë.

Në të njëjtën kohë, ICC ka shprehur shqetësimin e saj për ndikimet shkatërruese të praktikave korruptive në biznes. Është bërë e qartë se korrupsioni përbën pengesë për krijimin e një terreni të barabartë të cilin të gjitha korporatat duan të shohin të konkretizohet, dhe bie ndesh me rendin publik ndërkombëtar.

Si rrjedhojë, në vitin 1977 ICC prezantoi Rregulloren e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit ("Rregullorja"), duke u bërë kështu organizata e parë ndërkombëtare që publikon një rregullore e cila dënon të gjitha format e korrupsionit dhe i nxit shoqëritë që të hartojnë masa parandaluese për të ndaluar korrupsionin në transaksionet e tyre.

Rregullat vullnetare të ICC-së janë rishikuar rregullisht për të pasqyruar praktikat më të mira të korporatës dhe për të pasqyruar dispozitat e instrumenteve kryesore ndërkombëtare kundër ryshfetit, të tilla si Konventa e OECD-së për Luftën kundër Korrupsionit të Zyrtarëve të Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare Tregtare (1997) dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003).

Për të konsoliduar progresin e bërë nga bota e biznesit në praktikën e saj korporative, Rregullorja e ICC-së u rishikua në vitin 2011. Rregullorja e botuar në vitin 2011 përmban tre pjesë: Pjesa I përcakton Rregullat e duhura, Pjesa II trajton politikat që sipërmarrjet duhet të miratojnë për të mbështetur pajtueshmërinë me Rregulloren dhe Pjesa III rendit elementët e sugjeruar të një programi efikas të pajtueshmërisë së korporatës. Rregullorja e vitit 2011 është projektuar për t'u zbatuar nga sipërmarrjet e çdo madhësie, qoftë të mëdha, të mesme apo të vogla.

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë çmon se misioni i saj nuk përfundon me parashikimin e normave vullnetare kundër korrupsionit, por përfshin edhe nxitjen e shoqërive për të përfshirë në marrëveshjet e tyre, në mënyrë të plotë ose me anë të referencës, dispozita kundër korrupsionit qoftë në formën e standardeve bazë kundër korrupsionit të ICC-së të renditura në Pjesën I të Rregullores së vitit 2011, ose me miratimin e një programi të pajtueshmërisë së korporatës, siç rekomandohet nga neni 10 i Rregullores së vitit 2011.

Klauzola aktuale kundër Korrupsionit e ICC-së do të ndihmojë personat nga bota e biznesit dhe konsulentët e tyre për të bërë një referencë të tillë thelbësore, me qëllim krijimin e besimit dhe që marrëdhëniet e tyre kontraktuale të mos cenohen nga praktikat korruptive.

**Jean-Guy Carrier**

## Shënim hyrës për zbatimin dhe qëllimin e përgjithshëm dhe strukturën e klauzolës

Kjo Klauzolë kundër Korrupsionit e ICC-së ("Klauzola") synon të zbatohet për çdo kontratë që e përfshin ose me anë të referencës, ose në mënyrë të plotë. Ndërsa palët e një kontrate nxiten të përfshijnë Klauzolën në kontratën e tyre me emrin e saj të plotë, parashikohet që çdo referencë në kontratë e "Klauzolës" ose varianteve të lidhura me të, në rast se nuk vërtetohet e kundërta, të konsiderohet një referencë e Klauzolës kundër Korrupsionit të ICC-së.

Qëllimi i përgjithshëm i Klauzolës është që t'u sigurojë palëve një dispozitë kontraktuale e cila do t'i risigurojë ato për integritetin e palëve të tyre homologe gjatë periudhës parakontraktuale, si dhe gjatë afatit të kontratës dhe madje edhe në një kohë të mëvonshme.

Ekzistojnë tre opsione të mundshme: ose një tekst i shkurtër me teknikën e përfshirjes me anë të referencës së Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 (Opsioni I), ose të përfshirjes së tekstit të plotë të të njëjtës Pjesë I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 në kontratën e tyre (Opsioni II), ose një referencë të një programi përputhshmërie të korporatës, siç përshkruhet në nenin 10 të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit (Opsioni III).

Nëse rastet kur janë zgjedhur Opsionet I dhe II, nëse njëra palë nuk respekton në masë të konsiderueshme ose në disa raste të përsëritura dispozitat kundër korrupsionit të përfshira në kontratë, palës që nuk ka respektuar dispozitat do t'i jepet mundësia të bëjë korrigjimet e duhura për të qenë në pajtim me to. Gjithashtu, kësaj pale do t'i jepet mundësia të parashtrijë si mbrojtje se ka vendosur masa të përshtatshme parandaluese kundër korrupsionit. Në rast se pala e cila nuk është në respektim të dispozitave nuk merr masa korrigjuese ose nëse masat korrigjuese nuk janë të mundura dhe nuk është parashtruar asnjë mbrojtje konkrete, pala tjetër mund të pezullojë ose të zgjidhë kontratën, sipas gjykimit të saj.

Çdo subjekt, qoftë gjykatë arbitrazhi ose organ tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili jep një vendim në përputhje me dispozitat e kontratës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ka autoritetin për të përcaktuar pasojat kontraktuale të çdo pretendimi për mosrespektim të Klauzolës.

## Klauzola kundër Korrupsionit e ICC-së

### A. Opsioni I: Përfshirja me anë të referencës e Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011

#### Paragrafi 1

Me anë të kësaj, secila Palë merr përsipër që në datën e hyrjes në fuqi të Kontratës, ajo vetë, drejtorët, zyrtarët ose punonjësit e saj nuk kanë ofruar, premtuar, dhënë, autorizuar, kërkuar ose pranuar ndonjë avantazh të padrejtë financiar ose avantazh tjetër të çdo lloji (ose nuk kanë nënkuptuar se do të bëjnë ose mund të veprojnë kështu në çdo kohë në të ardhmen) në ndonjë mënyrë të lidhur me Kontratën dhe se ka marrë masa të arsyeshme për të parandaluar nënkontraktuesit, agjentët ose palë të tjera të treta, objekt i kontrollit të saj ose ndikimit përcaktues, për të vepruar në këtë mënyrë.

#### Paragrafi 2

Palët bien dakord se në çdo kohë në lidhje me dhe gjatë Kontratës dhe më pas, ato do të respektojnë dhe do të marrin masa të arsyeshme për të siguruar se nënkontraktuesit, agjentët ose palë të tjera të treta të tyre, objekt i kontrollit të tyre ose ndikimit përcaktues, do të jenë në përputhje me Pjesën I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, e cila është përfshirë me anë të referencës në Kontratë sikurse të ishte e shkruar plotësisht në Kontratë.

#### Paragrafi 3

Nëse një Palë, si rezultat i ushtrimit të së drejtës së auditimit të parashikuar në kontratë, nëse ka, të regjistrave financiarë dhe librave të kontabilitetit të Palës tjetër, ose ndryshe, paraqet prova se kjo Palë është përfshirë në shkelje të rënda ose në disa shkelje të përsëritura të dispozitave të Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, ajo do ta njoftojë këtë Palë në mënyrën e duhur dhe do të kërkojë që kjo Palë të marrë masat e nevojshme korrigjuese në një kohë të arsyeshme dhe ta vërë në dijeni për këto masa. Nëse kjo Palë nuk mund të marrë masat e nevojshme korrigjuese ose nëse këto masa korrigjuese nuk janë të mundura, ajo mund të parashtojë si mbrojtje duke vërtetuar se në momentin kur kanë dalë prova të shkeljeve, ajo ka marrë masa të përshtatshme parandaluese kundër korrupsionit, siç përshkruhen në nenin 10 të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, të përshtatura sipas rrethanave të saj të veçanta dhe që mund të zbulojnë korrupsionin dhe të nxisin një kulturë integriteti në organizatën e saj. Nëse nuk është marrë asnjë masë korrigjuese ose, sipas rastit, nuk është parashtruar asnjë mbrojtje konkrete, sipas gjykimit të saj, Pala e parë mund të pezullojë Kontratën ose ta zgjidhë atë, duke nënkuptuar se të gjitha shumat që duhen paguar sipas kontratës deri në momentin e pezullimit ose zgjidhjes së saj do të mbeten të pagueshme në masën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

#### Paragrafi 4

Çdo subjekt, qoftë gjykatë arbitrazhi ose organ tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili jep një vendim në përputhje me dispozitat e Kontratës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ka autoritetin për të përcaktuar pasojat kontraktuale nga çdo pretendim për mosrespektimin e kësaj Klauzole kundër Korrupsionit të ICC-së.

## B. Opsioni II: Përfshirja e plotë e Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011

### Paragrafi 1

Me anë të kësaj, secila Palë merr përsipër që në datën e hyrjes në fuqi të Kontratës, ajo vetë, drejtorët, zyrtarët ose punonjësit e saj nuk kanë ofruar, premtuar, dhënë, autorizuar, kërkuar ose pranuar ndonjë avantazh të padrejtë financiar ose avantazh tjetër të çdo lloji (ose nuk kanë nënkuptuar se do të bëjnë ose mund të veprojnë kështu në çdo kohë në të ardhmen) në ndonjë mënyrë të lidhur me Kontratën dhe se ka marrë masa të arsyeshme për të parandaluar nënkontraktuesit, agjentët ose palë të tjera të treta, objekt i kontrollit të saj ose ndikimit përcaktues, për të vepruar në këtë mënyrë.

### Paragrafi 2

Palët bien dakord se në çdo kohë në lidhje me dhe gjatë Kontratës dhe më pas, ato do të respektojnë dhe do të marrin masa të arsyeshme për të siguruar se nënkontraktuesit, agjentët ose palë të tjera të treta të tyre, objekt i kontrollit të tyre ose ndikimit përcaktues, do të respektojnë dispozitat e mëposhtme:

#### Paragrafi 2.1

Palët do të ndalojnë praktikat e mëposhtme në çdo kohë dhe formë në lidhje me një zyrtar publik në nivel ndërkombëtar, kombëtar ose vendor, parti politike, zyrtar partiak ose kandidat për një post politik dhe drejtor, zyrtar ose punonjës të një Pale, pavarësisht nëse përfshirja në këto praktika është e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, duke përfshirë edhe nëpërmjet palëve të treta:

- a) **Ryshfeti** është oferta, premtimi, dhënia, autorizimi ose pranimi i çdo avantazhi të padrejtë financiar ose jo nga ose për çdo person të renditur më lart ose për çdo person tjetër, me qëllim marrjen ose mbajtjen e një biznesi ose avantazhi tjetër të pamerituar, për shembull në lidhje me dhëniet e kontratave të prokurimit publik ose privat, lejet rregullatore, procedurat tatimore, doganore, gjyqësore dhe legislative.

Ryshfeti shpesh përfshin:

- (i) përqindjen e një pjese të pagesës së kontratës për zyrtarë qeveritarë ose partiakë ose për punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre të ngushtë, miq ose partnerë biznesi, ose
  - (ii) përdorimin e ndërmjetësve të tillë si agjentë, nënkontraktues, konsulentë ose palë të tjera të treta për të kanalizuar pagesat te zyrtarët qeveritarë ose partiakë ose te punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre, miq ose partnerë biznesi.
- b) **Zhvatja ose kërkimi me forcë** është, në rast se kërkesa për ryshfet refuzohet, kërkimi i një ryshfeti, pavarësisht nëse shoqërohet apo jo me një kërcënim. Secila Palë do të kundërshtojë çdo tentativë për zhvatje ose kërkim me forcë dhe nxitet që t'i raportojë këto tentativa nëpërmjet mekanizmave të disponueshëm formalë ose informalë të raportimit, përveçse nëse ky raportim konsiderohet si kundërproduktiv në raport me rrethanat.



- c) **Shfrytëzimi i ndikimit** është ofrimi ose kërkimi me forcë i një avantazhi të padrejtë, me qëllim ushtrimin e një ndikimi të pamerituar, real ose të supozuar me qëllim sigurimin nga një zyrtar publik të një avantazhi të padrejtë për iniciatorin e veprimit ose për çdo person tjetër.
- d) **Pastrimi i produkteve nga praktikatat korruptive të lartpërmendura** është fshehja ose mbulimi i origjinës, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë së paligjshme të pasurisë, me dijeninë se kjo pasuri është produkt i krimit.

“Korrupsion” ose “Praktika Korruptive”, siç përdoren në këtë Klauzolë kundër Korrupsionit të ICC-së, përfshin ryshfetin, zhvatjen ose kërkimin me forcë, shfrytëzimin e ndikimit dhe pastrimin e produkteve nga këto praktika.

### Paragrafi 2.2

Në lidhje me palët e treta, objekt i kontrollit ose ndikimit përcaktues të një Pale, duke përfshirë por pa u kufizuar me agentët, konsulentët e zhvillimit të biznesit, përfaqësuesit e shitjeve, agentët doganorë, konsulentët e përgjithshëm, rishitësit, nënkontraktuesit, franshiz marrësit, avokatët, kontabilistët ose ndërmjetësit e ngjashëm që veprojnë në emër të Palës në lidhje me marketingun ose shitjet, negocimin e kontratave, marrjen e licencave, lejeve ose të autorizimeve të tjera ose me veprime në interes të Palës ose si nënkontraktues në zinxhirin e furnizimit, Palët duhet t'i udhëzojnë të mos përfshihen, as të tolerojnë që të përfshihen në ndonjë akt korrupsioni; as t'i përdorin si mënyrë për praktika korruptive; t'i punësojnë vetëm në masën e nevojshme për kryerjen e rregullt të biznesit të Palës dhe të mos i paguajnë më shumë sesa shpërblimi i duhur për shërbimet e tyre legjitime.

### Paragrafi 3

Nëse një palë, si rezultat i ushtrimit të së drejtës së auditimit të parashikuar në kontratë, nëse ka, të regjistrave financiarë dhe librave të kontabilitetit të Palës tjetër, ose ndryshe, paraqet prova se kjo Palë është përfshirë në shkelje të rënda ose në disa shkelje të përsëritura të dispozitave të Paragrafëve 2.1 dhe 2.2 më lart, ajo do ta njoftojë këtë Palë në mënyrën e duhur dhe do të kërkojë që kjo Palë të marrë masat e nevojshme korrigjuese në një kohë të arsyeshme dhe ta vërë në dijeni për këto masa. Nëse kjo Palë nuk mund të marrë masat e nevojshme korrigjuese ose nëse këto masa korrigjuese nuk janë të mundura, ajo mund të parashtojë si mbrojtje duke vërtetuar se në momentin kur kanë dalë prova të shkeljeve, ajo ka marrë masa të përshtatshme parandaluese kundër korrupsionit, siç përkruhen në nenin 10 të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, të përshtatura sipas rrethanave të saj të veçanta dhe që mund të zbulojnë korrupsionin dhe të nxisin një kulturë integriteti në organizatën e saj. Nëse nuk është marrë asnjë masë korrigjuese ose, sipas rastit, nuk është parashikuar asnjë mbrojtje konkrete, sipas gjykimit të saj, Pala e parë mund të pezullojë ose ta zgjidhë Kontratën, duke nënkuptuar se të gjitha shumat që duhen paguar sipas kontratës deri në momentin e pezullimit ose zgjidhjes së saj do të mbeten të pagueshme në masën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

### Paragrafi 4

Çdo subjekt, qoftë gjykatë arbitrazhi ose organ tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili jep një

vendim në përputhje me dispozitat e Kontratës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ka autoritetin për të përcaktuar pasojat kontraktuale nga çdo pretendim për mosrespektimin e kësaj Klauzole kundër Korrupsionit të ICC-së.

### **C. Opsioni III: Referenca e një programi të përputhshmërisë me luftën kundër korrupsionit të korporatës, siç përshkruhet në nenin 10 të Rregullores së vitit 2011**

#### **Paragrafi 1**

Secila Palë duhet të krijojë, në datën e hyrjes në fuqi të Kontratës, ose të marrë përsipër të krijojë brenda një kohe të shpejtë të mëpasshme, një program të pajtueshmërisë për luftën kundër korrupsionit të korporatës, siç përshkruhet në nenin 10 të Rregullores së ICC-së të vitit 2011 për Luftën kundër Korrupsionit, të përshtatur sipas rrethanave të saj të veçanta dhe që mund të zbulojnë korrupsionin dhe të nxisin një kulturë integriteti në organizatën e saj.

Secila Palë do të mbajë dhe zbatojë një program të tillë të paktën gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës dhe do të informojë rregullisht Palën tjetër për zbatimin e programit të saj nëpërmjet deklaratave të përgatitura nga një përfaqësues i kualifikuar i korporatës i caktuar prej saj dhe emri i të cilit i është komunikuar Palës tjetër.

#### **Paragrafi 2**

Nëse një Palë paraqet prova se deklarata e përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës së Palës tjetër përmban mangësi të konsiderueshme që cenojnë efikasitetin e programit të Palës tjetër, ajo do të njoftojë Palën tjetër në mënyrën e duhur dhe do t'i kërkojë asaj Palë të marrë masat e nevojshme korrigjuese në një kohë të arsyeshme dhe ta vërë në dijeni për këto masa. Nëse kjo e fundit nuk merr asnjë masë korrigjuese ose nëse këto masa korrigjuese nuk janë të mundura, sipas gjykimit të saj, Pala e parë mund të pezullojë Kontratën ose ta zgjidhë atë, duke nënkuptuar se të gjitha shumat që duhen paguar sipas kontratës deri në momentin e pezullimit ose zgjidhjes së saj do të mbeten të pagueshme në masën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

#### **Paragrafi 3**

Çdo subjekt, qoftë gjykatë arbitrazhi ose organ tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili jep një vendim në përputhje me dispozitat e Kontratës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ka autoritetin për të përcaktuar pasojat kontraktuale nga çdo pretendim për mosrespektimin e kësaj Klauzole kundër Korrupsionit të vitit 2012.

## Komentar për Klauzolën kundër Korrupsionit të ICC-së

### Opsionet I dhe II

#### Paragrafi 1: Angazhimi kundër korrupsionit që mbulon periudhën parakontraktuale

##### 1. Klauzola kundër Korrupsionit e ICC-së synon krijimin e besimit ndërmjet Palëve

Integriteti është faktor kyç për krijimin e një mjedisi biznesi që i jep vlerë në kohë parasë dhe shpërblen aftësinë dhe konkurueshmërinë. Rezultatet më të mira në transaksionet e biznesit arrihen kur midis Palëve mbizotërojnë parashikueshmëria dhe besimi. Lufta kundër ryshfetit dhe praktikave të tjera korruptive është gjithashtu jetike për mbrojtjen e aksionarëve, taksapaguesve dhe të subjekteve që preken në mënyrë të tërthortë nga transaksionet e biznesit.

Ndërsa ekziston nevoja për të garantuar që praktikat korruptive nuk do të lulëzojnë, gjithashtu ekziston nevoja për të ruajtur besimin në karakterin detyrues të angazhimeve kontraktuale (pacta sunt servanda), pasi ky është komponenti kryesor i jetëgjatësisë së suksesshme të biznesit. Prandaj, duhet të ketë një ekuilibër midis përpjekjeve për të luftuar korrupsionin dhe trajtimit të korrupsionit si shkelje të një Kontrate për të justifikuar zgjidhjen e saj.

Gjatë jetëgjatësisë së një veprimtarie biznesi duhet të mbizotërojë integriteti, nga negocimi deri te realizimi dhe shpërblimi si rezultat i tij. Shpesh herë një transaksion kontraktual përfshin shumë Palë me numër të konsiderueshëm personeli. Praktikak korruptive mund të mos ekzistojnë në të gjithë organizatën dhe mund të mos nxiten nga ose t'i atribuohen nivelit drejtues i cili ka përgjegjësinë kryesore për negocimin ose realizimin e Kontratës.

Gjatë përgatitjes së Kontratës, Palët dëshirojnë të garantojnë se gjatë negociatave për lidhjen e Kontratës dhe gjatë hartimit të Kontratës (periudha parakontraktuale), asnjë ryshfet, dhuratë ose avantazh tjetër i padrejtë nuk është dhënë ose premtuar (ose nuk është shfaqur asnjë shenjë se diçka e tillë mund të ndodhë në të ardhmen) në lidhje me Kontratën nga një Palë te një zyrtar publik në nivel ndërkombëtar, kombëtar ose vendor, një parti politike, zyrtar partiak ose kandidat për një post politik dhe drejtor, zyrtar ose punonjës të Palës tjetër, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi nëpërmjet një prej nënkontraktuesve, agjentëve të Palës ose një pale tjetër të tretë, objekt i kontrollit të saj ose ndikimit përcaktues.

Gjithashtu, secila Palë dëshiron të sigurojë se Pala tjetër ka vendosur masa të arsyeshme parandaluese për të shmangur përfshirjen në praktika korruptive të nënkontraktuesve, agjentëve ose palëve të tjera të treta të Palës tjetër.

Në fjalë të tjera, Klauzola është hartuar me synim arritjen e një ekuilibri midis interesit të Palëve për të shmangur korrupsionin dhe nevojës së tyre për të garantuar arritjen e objektivave të Kontratës. Klauzola mbështetet në doktrinën e mirëbesimit, prezumimin e pafajësisë, bashkëpunimin e mirë ndërmjet Palëve dhe idenë se shumë praktika të paligjshme mund të ndiqen pa i dhënë fund marrëdhënies kontraktuale.

##### 2. Cilat janë Praktikak Korruptive që mbulon paragrafi 1?

Formulimi i paragrafit 1 pasqyron atë të përdorur në Konventën e OECD-së për Luftën kundër

Korrupsionit të Zyrtarëve të Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare Tregtare (1997) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003).

Praktikat korruptive që mbulon paragrafi 1 përfshijnë: (i) korrupsionin “aktiv” dhe “pasiv” (gjithashtu të referuar ndonjëherë si “Zhvatje” ose “Kërkim me forcë”); (ii) Ryshfetin si dhe shfrytëzimin e ndikimit; (iii) Korrupsionin e zyrtarëve publikë, si dhe korrupsionin midis subjekteve private; (iv) Korrupsionin në sferën kombëtare dhe vendore, si dhe në atë ndërkombëtare; (v) Korrupsionin me ose pa përdorimin e ndërmjetësve; (vi) Ryshfetin me para ose me anë të ndonjë forme tjetër avantazhi të padrejtë; dhe (vii) Ryshfetin si produkt ose jo i pastrimit të parave.

### **3. A i referohet paragrafi 1 qoftë edhe avantazheve më të vogla të padrejta?**

ICC u rekomandon sipërmarrjeve që të mos kryejnë “pagesa lehtësuese” (konkretisht, pagesa të vogla, të pamerituara, në mënyrë jozyrtare që u jepen një zyrtari të nivelit të ulët për të siguruar ose përshpejtuar realizimin e një veprimi rutinë ose të nevojshëm për të cilin pagesi ka të drejtë ligjore), përveçse nëse punonjësit e tyre përballen me rrethana urgjente, si për shembull shtrënguese ose kur rrezikohet shëndeti, siguria ose mbrojtja e punonjësve të tyre.

Për sa i përket ofrimit të dhuratave dhe mikpritjes, për shembull, ndaj partnerëve realë ose të mundshëm tregtarë, ICC-ja rekomandon që sipërmarrjet të krijojnë procedura për të garantuar se ato (i) janë në përputhje me ligjin; (ii) janë të arsyeshme dhe legjitime; (iii) nuk cenojnë (ose nuk konstatohet se cenojnë) pavarësinë e gjykimit të marrësit kundrejt dhënësit; (iv) nuk bien ndesh me dispozitat e njohura të kodit të sjelljes së marrësit dhe (v) nuk janë ofruar ose nuk janë marrë në periudha të shpeshta dhe as në një kohë të papërshtatshme.

### **4. Cilat “masa të arsyeshme parandaluese” duhet të merren nga Palët në lidhje me ndërmjetësit e tyre?**

Një Pale nuk i kërkohet të parandalojë me çdo lloj mjeti nënkontraktuesit, agjentët ose palë të tjera të treta, objekt i kontrollit të saj ose ndikimit përcaktues, nga kryerja e ndonjë forme praktike korruptive.

Megjithatë, secila Palë, në bazë të një vlerësimi periodik të rreziqeve me të cilat përballen, krijon një program efikas të pajtueshmërisë së korporatës, të përshtatur ndaj rrethanave të saj të veçanta; ushtron, mbi bazën e një qasjeje të strukturuar të menaxhimit të rrezikut, verifikimin e duhur paraprak në përzgjedhjen e nënkontraktuesve, agjentëve ose palëve të tjera të treta, objekt i kontrollit të saj ose ndikimit përcaktues, dhe trajnon drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e saj sipas rrethanave.

### **5. Në cilat rrethana është i zbatueshëm angazhimi sipas paragrafit 1?**

Duke pasur parasysh evoluimin e shpejtë të legjislacionit dhe praktikës në fushën e integritetit të biznesit, angazhimi sipas paragrafit 1 duhet të lidhet vetëm me Kontratën në vetvete dhe jo me kontrata të tjera të lidhura ndërmjet të njëjtat Palëve ose me çfarëdolloj kontrate tjetër.

## Paragrafi 2: Angazhimi kundër korrupsionit që mbulon periudhën pas ekzekutimit të Kontratës (periudhat kontraktuale dhe post-kontraktuale)

### 1. Afati i angazhimit të Palëve kundër korrupsionit

Gjatë periudhës pas hyrjes në fuqi të Kontratës dhe pas afatit të Kontratës, Palët bien dakord të mos kryejnë praktika korruptive në lidhje me Kontratën.

Ato do të duhet të garantojnë se asnjë fazë e realizimit të Kontratës, të tillë si marrja e licencave përkatëse ose autorizimeve zyrtare, kalimi i testeve operacionale ose inspektimet e mallrave ose ambienteve nuk do të sigurohen me anë të mjeteve të paligjshme. Ato gjithashtu angazhohen të ndërmarrim masa të arsyeshme për të parandaluar nënkontraktuesit, agjentët dhe palë të tjera të treta për të vepruar në të njëjtën mënyrë gjatë kësaj periudhe. Angazhimi i palëve kundër korrupsionit vazhdon edhe pas afatit të Kontratës.

### 2. Paragrafi 2 përmban një dispozitë për përfshirje ose me anë të referencës, ose në mënyrë të plotë.

Me qëllim materializimit të angazhimit të tyre reciprok kundër korrupsionit, Palët vendosin të përfshijnë në Kontratën e tyre tekstin e Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011. Ato mund të zgjedhin ta bëjnë këtë përfshirje ose me anë të referencës, ose në mënyrë të plotë. Në rastin e përfshirjes me anë të referencës, ato do të zgjedhin tekstin sipas Opsionit I, në rastin e përfshirjes në mënyrë të plotë, do të zgjedhin tekstin sipas Opsionit II.

Për qëllim lehtësie, teksti i Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 i bashkëlidhet këtij dokumenti si Shtojca I.

### 3. Karakteri i sipërmarrjes së Palëve

Sipërmarrja e palëve është absolute, ndërsa sipërmarrja e tyre në lidhje me nënkontraktorë, agjentë ose palë të tjera të treta, që janë nën kontrollin ose ndikimin vendimtar të tyre, kufizohet te marrja e "masave të arsyeshme", me qëllim parandalimit të këtyre të fundit nga përfshirja në praktika korruptive.

Kjo do të përfshijë minimalisht: udhëzimin e nënkontraktorëve, agjentëve dhe palëve të tjera të treta që të mos përfshihen, as të tolerojnë që të përfshihen në ndonjë praktikë korruptive; mospërdorimin e tyre si mënyrë për praktikë korruptive; kontraktimin e tyre vetëm në masën e nevojshme për ushtrimin e rregullt të aktivitetit të Palës dhe mospagimin e tyre më shumë sesa shpërblimi i duhur për shërbimet e tyre legjitime.

## Paragrafi 3: Mospërputhshmëria, masa korigjuese dhe sanksione

### 1. Mospërputhshmëria me Pjesën I të Rregullores së ICC-së.

Nëse një Palë vihet në dijeni se Pala tjetër ka kryer disa shkelje materiale ose të përsëritura të dispozitave të Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, do të njoftojë Palën tjetër përkatësisht.

Një palë që raporton një rast korrupsioni duhet të paraqesë prova për këtë. Provat janë shpesh të vështira për tu gjetur, ashtu siç është i vështirë edhe raportimi i tyre te Pala tjetër, pa i humbur ato ose pa shkaktuar dëm për përdorimin e tyre të mëtejshëm. Si rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e provave nuk nënkupton domosdoshmëri se duhet të paraqiten dëshmi provuese ose që Palës tjetër t'i jepen në çdo rast të gjitha

provat. Megjithatë, provat duhet të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar se dyshimet për korrupsion nuk janë raportuar në një mënyrë tendencioze ose të pajustificuar.

Klauzola nuk përfshin asnjë kërkesë formale për mënyrën sesi Palët duhet të bëjnë një njoftim për shkelje të dyshuar, sipas Pjesës I të Rregullores, por zakonisht për këtë lloj njoftimi do të zbatohet mekanizmi që ndiqet gjerësisht për komunikimet kontraktuale mes Palëve. Kështu, një Kontratë që përmban një kërkesë se çdo njoftim do të bëhet me shkrim, do të mbulojë edhe njoftimet për korrupsionin e dyshuar.

## **2. Masa korrigjuese të mundshme**

Me qëllim sigurimin në shkallën më të lartë të mundshme të vazhdimësisë së një Kontrate, Pala që dyshohet të mos ketë përmbushur detyrimet do të lejohet të rregullojë situatën në masën e mundshme. Masa të nevojshme korrigjuese mund të përfshijnë ofrimin e bashkëpunimit në aksionin provues, gjatë kryerjes së një shqyrtimi ose kërkimin e një auditimi të jashtëm të incidentit, nxjerrjen e paralajmërimeve, riorganizimin e punës, zgjidhjen e nënkontratave ose kontratave të punësimit me persona ose punëmarrës të përfshirë në korrupsion, ose korrigjimin e efektit të dëmshëm ekonomik që ndonjë mospërputhje e provuar ka të Pala tjetër, për shembull, duke ndryshuar vlerën e çmimit të Kontratës. Karakteri dhe numri i masave korrigjuese të kërkuara për Palën e dyshuar do të varen nga rrethanat e çështjes në fjalë, për shembull nga shkalla e shkeljes dhe nga sa bindëse do të jenë provat e paraqitura. Në disa situata, një mjet rregullues mund të përbëhet vetëm nga dhënia e provave kundërshtuese në lidhje me mosekzistencën e ndonjë shkeljeje. Pala e dyshuar për mospërmbushje të detyrimeve do të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Palën tjetër për masat që ka marrë për rregullimin e situatës.

Megjithatë, pranohet se jo çdo shkelje e dispozitave anti-korrupsion mund të ndreqet, por Pala e dyshuar për mospërmbushje të detyrimeve pritet të bëjë përpjekjet maksimale për të rregulluar situatën sa më mirë që mundet.

## **3. Mbrojtja me anë të masave të përshtatshme parandaluese anti-korrupsion.**

Nëse një mjet rregullues nuk zbatohet ose nuk mund të zbatohet, Pala e dyshuar për shkelje mund të kërkojë mbrojtje duke provuar se deri në kohën kur janë shfaqur prova të shkeljes, ka pasur në zbatim masa të përshtatshme parandaluese anti-korrupsion, siç përshkruhen në nenin 10 të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, të përshtatur ndaj rrethanave të saj specifike dhe të përshtatshme për të zbuluar korrupsionin dhe nxitur një kulturë integriteti në organizatën e vet. Këto masa të përshtatshme parandaluese anti-korrupsion duhet (i) të reflektojnë Rregulloren e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, (ii) të bazohen në rezultatet e një vlerësimi të kryer periodikisht të rreziqeve me të cilat përballet mjedisi i biznesit të Palës, dhe (iii) të përshtaten ndaj rrethanave të veçanta të Palës.

Për lehtësi referimi, teksti i nenit 10 të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 i bashkëlidhet këtij dokumenti si Shtojca II.

## **4. Prova të mospërputhshmërisë**

Përgatitja e provave për një shkelje të dispozitave anti-korrupsion, të përcaktuara në Pjesën I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, nuk do të jetë detyrë e lehtë, pasi korrupsioni ndodh shumë rrallë hapur.

Një prej pak mjeteve për përgatitjen e këtyre provave do të jetë dhënia e rezultateve të një auditimi të

librave kontabël dhe të dhënave financiare të Palës së dyshuar për mospërmbushje të detyrimeve. Ndonjëherë mund të përdoren deklaratat e dëshmitarit (si rezultat i një mekanizmi sinjalizues "whistleblowing" ose ndryshe). E drejta e zbatueshme penale duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të përfshirjes së organeve ligjzbatuese.

### **5. E drejta e auditimit**

Megjithatë, referenca në Klauzolë ndaj një të drejte auditimi të parashikuar nga pikëpamja kontraktuale nuk nënkupton se një e drejtë auditimi mund të sigurohet lehtësisht në të gjitha rrethanat, as se kjo e drejtë auditimi do të jetë e përshtatshme për të gjitha situatat. Megjithëse disa Kontrata i japin një ose më shumë Palëve të drejtën për të kryer një auditim të Palët e tjera, referenca në këtë Klauzolë ndaj një të drejte auditimi nuk nënkupton se ICC-ja mbështet dhënien e të drejtës për kryerjen e një auditimit të thelluar si një praktikë e rekomanduar biznesi.

Palët do të duhet të përcaktojnë nëse marrëdhënia e tyre tregtare mundëson një të drejtë auditimi dhe nëse rrethanat për negociimin dhe zbatimin e ardhshëm të Kontratës justifikojnë nevojën për këtë të drejtë auditimi.

### **6. Sanksionet**

Nëse Pala që dyshohet të ketë shkelur dispozita të Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011, nuk korrigjon shkeljen brenda një periudhe të arsyeshme ose nëse korrigjimi i shkeljes nuk është i mundur, dhe në të vërtetë nuk është kërkuar asnjë mbrojtje e masave të përshtatshme parandaluese anti-korrupsion, Pala tjetër do të ketë të drejtën që, sipas gjykimit të vet, të pezullojë Kontratën ose ta zgjidhë atë, ku kuptohet që shumat kontraktuale të pagueshme deri në momentin e pezullimit ose të zgjidhjes të mbeten të pagueshme në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm.

Kur Pala tjetër ushtron të drejtën e saj të pezullimit ose zgjidhjes, ajo mban barrën e plotë të provës se kanë ndodhur shkelje të dispozitave të Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011.

Ligji i zbatueshëm mund të përcaktojë nëse Pala mund të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të Pjesës I të Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011.

Zgjidhja e një kontrate të zgjeruar ose afatgjatë për shkak të një shkeljeje mund të jetë joproporcionale. Ky fakt duhet të merret gjithashtu parasysh në zbatimin e paragrafit 3 të Klauzolës.

### **Paragrafi 4: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për çdo mosmarrëveshje lidhur me pasojat kontraktuale të çdo shkeljeje të dyshuar të Klauzolës, Palët i drejtohen autoritetit që parashikohet në dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Kontratë, si për shembull një gjykatë arbitrazhi. Megjithatë, shkelja mund t'i nënshtrohet ndjekjes penale të njëkohshme, që mund të sjellë sanksione penale ose pasoja të të drejtës civile të ndryshme nga ato kontraktuale, në veçanti përgjegjësi ligjore për dëmin e shkaktuar.

## Opsioni III

### Paragrafi 1: Programet e përputhshmërisë së korporatës

#### 1. Programet e përputhshmërisë së korporatës, siç përshkruhen në nenin 10 të Rregullores së ICC-së

Shumë shoqëri kanë në zbatim një program të përputhshmërisë së korporatës, me synim parandalimin e ndikimit të praktikave korruptive në veprimtarinë e tyre të biznesit. Këto programe mund të kenë forma dhe përmbajtje të ndryshme dhe do të duhet të përshtaten sipas rrethanave specifike të secilës shoqëri, me qëllim që të jenë të efektshme. Gjithashtu, ato duhet të mundësojnë zbulimin e korrupsionit dhe duhet të synojnë nxitjen e një kulture integriteti në organizatë.

Neni 10 i Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit të vitit 2011 parashikon një listë të zgjeruar, jo gjithëpërfshirëse, të masave që mund të përfshihen në një program të tillë. Secila shoqëri do të përzgjedhë nga lista masat që çmon të nevojshme ose të përshtatshme për organizimin e sistemit të vet të parandalimit anti-korrupsion.

#### 2. Përgatitja e një programi të përputhshmërisë së korporatës

Kur Palët lidhin një Kontratë, fakti që secila prej tyre ka në zbatim, ose është duke u përgatitur për të futur shumë shpejt në zbatim, një program të përputhshmërisë së korporatës, ndihmon në forcimin e besimit ndërmjet tyre. Palët do të angazhohen të mbajnë në fuqi programin e tyre të përputhshmërisë dhe të zbatojnë dispozitat e tij, të paktën gjatë afatit të Kontratës, në mënyrë që gjatë asaj periudhe të ruhet një klimë besimi ndërmjet Palëve.

#### 3. Caktimi i një përfaqësuesi të kualifikuar të korporatës

Me qëllim evidentimin e efektshmërisë së programit dhe vazhdimësinë e zbatimit të tij, secila Palë do të caktojë nga personeli i saj një përfaqësues të kualifikuar të korporatës, emri i të cilit do t'i njoftohet Palës tjetër. Këta përfaqësues të kualifikuar të korporatës do të lëshojnë, në intervale të rregullta kohore, deklarata për ekzistencën dhe zbatimin e vazhdueshëm të programit të shoqërisë së saj.

### Paragrafi 2: Të metat në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës, masat korrigjuese dhe sanksionet

#### 1. Të metat në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës.

Kur njëra Palë konstaton se deklarata e përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës së Palës tjetër përmban të meta të konsiderueshme, që cenojnë efikasitetin e programit të asaj Palë, njoftohet Pala tjetër përkatësisht. Një deklaratë do të konsiderohet e pamjaftueshme nëse përmban deklarime të pavërteta, të rreme ose të paplota nga pikëpamja materiale.

Një Palë që raporton një të metë në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës duhet të paraqesë prova se deklaratat mungojnë, ose se deklarata përmban deklarime të pavërteta, të rreme ose të paplota nga pikëpamja materiale.

Provat janë shpesh të vështira për tu gjetur, ashtu siç është i vështirë edhe raportimi i tyre te Pala tjetër, pa



i humbur ato ose pa shkaktuar dëm për përdorimin e tyre të mëtejshëm. Si rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e provave nuk nënkupton domosdoshmëri se duhet të paraqiten dëshmi provuese ose që Palës tjetër t'i jepen në çdo rast të gjitha provat. Megjithatë, provat duhet të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar se dyshimet për të metat në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës nuk janë raportuar në një mënyrë tendencioze ose të pajustificuar.

Klauzola nuk përfshin asnjë kërkesë formale për mënyrën sesi Palët duhet të bëjnë një njoftim për një të metë të dyshuar në një deklaratë të përfaqësuesit të kualifikuar të korporatës, por zakonisht për këtë lloj njoftimi do të zbatohet mekanizmi që ndiqet gjerësisht për komunikimet kontraktuale mes Palëve. Kështu, një Kontratë që përmban një kërkesë se çdo njoftim do të bëhet me shkrim, do të mbulojë edhe njoftimet për të metën e dyshuar.

### **2. Masa korigjuese**

Me qëllim sigurimin në shkallën më të lartë të mundshme të vazhdimësisë së një Kontrate, Palës që dyshohet të ketë lëshuar një deklaratë të pamjaftueshme, do t'i jepet mundësia të rregullojë situatën në masën e mundshme. Masa të nevojshme korigjuese mund të përfshijnë dhënien e një deklarate të re, të saktë, të plotë dhe të vërtetë, që jep informacion të plotë dhe të qartë të zbatimit nga Pala përkatëse të dispozitave të programit të saj të përputhshmërisë së korporatës, si dhe çdo masë korigjuese që kjo Palë do të marrë për përmirësimin e zbatimit të programit të saj. Karakteri dhe numri i masave korigjuese të kërkuara për Palën e dyshuar do të varen nga rrethanat e çështjes në fjalë, për shembull nga shkalla e shkeljes dhe sesa bindëse do të jenë provat e paraqitura. Në disa situata, një mjet rregullues mund të përbëhet vetëm nga dhënia e provave kundërshtuese në lidhje me mosekzistencën e ndonjë të metë. Pala e dyshuar për mospërbushje të detyrimeve do të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Palën tjetër për masat që ka marrë për rregullimin e situatës.

Megjithatë, pranohet se jo çdo e metë mund të ndreqet, por Pala e dyshuar për mospërbushje të detyrimeve pritet të bëjë përpjekjet maksimale për të rregulluar situatën sa më mirë që mundet.

### **3. Komentat tjetër**

Komentari i parashikuar më sipër në pikat 4, 5 dhe 6 për paragrafin 3 të Opsioneve I dhe II, zbatohet *rust pas rasti* ndaj paragrafit 2 të Opsionit III.

### **Paragrafi 3: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për çdo mosmarrëveshje lidhur me çdo shkeljeje të dyshuar të Klauzolës, Palët i drejtohen autoritetit që parashikohet në dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Kontratë, si për shembull një gjykatë arbitrazhi. Megjithatë, shkelja mund t'i nënshtrohet procedurave paralele penale, që mund të sjellë sanksione penale ose pasoja të drejtës civile të ndryshme nga ato kontraktuale, në veçanti përgjegjësi ligjore për dëmin e shkaktuar.

## SHTOJCA I

### Pjesa I e Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit 2011

#### Neni 1

##### Praktikat e ndaluara

Sipërmarrjet do të ndalojnë praktikat e mëposhtme në çdo kohë dhe formë në lidhje me

- një zyrtar publik në nivel ndërkombëtar, kombëtar ose vendor,
- një parti politike, zyrtar partiak ose kandidat për një post politik dhe drejtor,
- zyrtar ose punonjës të një Sipërmarrjeje,

pavarësisht nëse përfshirja në këto praktika është e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, duke përfshirë edhe nëpërmjet Palëve të Treta:

- a) **Ryshfeti** është oferta, premtimi, dhënia, autorizimi ose pranimi i çdo avantazhi të padrejtë financiar ose jo nga ose për çdo person të renditur më lart ose për çdo person tjetër, me qëllim marrjen ose mbajtjen e një biznesi ose avantazhi tjetër të pamerituar, *për shembull*, në lidhje me dhëniet e kontratave të prokurimit publik ose privat, lejet rregullatore, procedurat tatimore, doganore, gjyqësore dhe legislative.

Ryshfeti shpesh përfshin (i) përqindjen e një pjese të pagesës së kontratës për zyrtarë qeveritarë ose partiakë ose për punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre të ngushtë, miq ose Partnerë Biznesi ose (ii) përdorimin e ndërmjetësve të tillë si agjentë, nënkontraktues, konsulentë ose Palë të tjera të Treta, për të kanalizuar pagesat te zyrtarët qeveritarë ose partiakë ose te punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre, miq ose Partnerë Biznesi.

- b) **Zhvatja ose kërkimi me forcë** është, në rast se kërkesa për ryshfet refuzohet, kërkimi i një ryshfeti, pavarësisht nëse shoqërohet apo jo me një kërcënim. Sipërmarrjet do të kundërshtojnë çdo tentativë për zhvatje ose kërkim me forcë dhe nxiten që t'i raportojnë këto tentativa nëpërmjet mekanizmave të disponueshëm formalë ose informalë të raportimit, përveçse nëse ky raportim konsiderohet si kundërproduktiv në raport me rrethanat.
- c) **Shfrytëzimi i ndikimit** është ofrimi ose kërkimi me forcë i një avantazhi të padrejtë, me qëllim ushtrimin e një ndikimi të pamerituar, real ose të supozuar me qëllim sigurimin nga një zyrtar publik të një avantazhi të padrejtë për nismëtarin e veprimit ose për çdo person tjetër.
- d) **Pastrimi i produkteve nga praktikat korruptive të lartpërmendura** është fshehja ose mbulimi i origjinës, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë së paligjshme të pasurisë, me dijeninë se kjo pasuri është produkt i krimit.

“Korrupsion” ose “Praktika Korruptive”, siç përdoren në këtë Rregullore, përfshin ryshfetin, zhvatjen ose kërkimin me forcë, shfrytëzimin e ndikimit dhe pastrimin e produkteve nga këto praktika.

## Neni 2

### *Palët e Treta*

Në lidhje me Palët e Treta, objekt i kontrollit ose ndikimit përcaktues të Sipërmarrjes, duke përfshirë por pa u kufizuar me agjentët, konsulentët e zhvillimit të biznesit, përfaqësuesit e shitjeve, agjentët doganorë, konsulentët e përgjithshëm, rishitësit, nënkontraktuesit, franshizë-marrësit, avokatët, kontabilistët ose ndërmjetësit e ngjashëm që veprojnë në emër të Sipërmarrjes në lidhje me marketingun ose shitjet, negocimin e kontratave, marrjen e licencave, lejeve ose të autorizimeve të tjera ose veprime në interes të Sipërmarrjes ose si nënkontraktues në zinxhirin e furnizimit, Sipërmarrjet duhet: t'i udhëzojnë të mos përfshihen, as të tolerojnë që të përfshihen në ndonjë akt korrupsioni; as t'i përdorin si mënyrë për praktika korruptive; t'i punësojnë vetëm në masën e nevojshme për kryerjen e rregullt të biznesit të Sipërmarrjes dhe të mos i paguajnë më shumë sesa shpërblimi i duhur për shërbimet e tyre legjitime.

## SHTOJCA II

### Neni 10 i Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit 2011

#### Elementët e një Programi të Përputhshmërisë së Korporatës.

Çdo Sipërmarrje duhet të zbatojë një Program efektiv të Përputhshmërisë së Korporatës (i) që reflekton këto Rregulla, (ii) që bazohet në rezultatet e një vlerësimi periodik të rreziqeve me të cilat përballet mjedisi i biznesit, (iii) që i përshtatet rrethanave specifike të Sipërmarrjes dhe (iv) që synon parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe nxitjes së një kulture integriteti në Sipërmarrje.

Çdo Sipërmarrje duhet të shqyrtojë përfshirjen e të gjithave ose të një pjese të praktikave pozitive të mëposhtme në programin e saj. Në veçanti, ajo mund të zgjedhë, ndër pikat e renditura më poshtë, ato masa që i konsideron më të përshtatshme për të siguruar parandalimin e duhur kundër korrupsionit në rrethanat e saj specifike, ku asnjë masë e tillë nuk ka karakter të detyrueshëm:

- a) shprehja e mbështetjes dhe angazhimit të fuqishëm, të qartë dhe të dukshëm ndaj Programit të Përputhshmërisë së Korporatës nga Bordi i Drejtorëve ose një organ tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen dhe nga këshilli i lartë drejtues i Sipërmarrjes (“sjellja etike”);
- b) krijimi i një politike transparente dhe të shprehur qartë, e cila reflekton këto Rregulla dhe është detyruese për të gjithë drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe Palët e Treta dhe që zbatohet për të gjitha filialet e kontrolluara, të huaja dhe vendase;
- c) caktimi i detyrës Bordit të Drejtorëve ose një organi tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen, ose një komiteti përkatës të saj, për të kryer vlerësime periodike risku dhe rishikime të pavarura të përputhshmërisë me këtë Rregullore dhe për të rekomanduar masa ose politika korrigjuese, sipas nevojës. Kjo mund të realizohet si pjesë e një sistemi të zgjeruar të shqyrtimeve të përputhshmërisë së korporatës dhe/ose vlerësimeve të riskut;
- d) ngarkimi me përgjegjësi i individëve në të gjitha nivelet e Sipërmarrjes, për respektimin e politikës së Sipërmarrjes dhe për pjesëmarrjen në Programin e Përputhshmërisë së Korporatës;
- e) caktimi i një ose më shumë zyrtarëve të lartë (me kohë të plotë ose të pjesshme) për të mbikqyrur dhe koordinuar Programin e Përputhshmërisë së Korporatës me një nivel të mjaftueshëm burimesh, autoriteti dhe pavarësie, duke i raportuar periodikisht Bordit të Drejtorëve ose një organi tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen, ose komitetit përkatës të tyre;
- f) nxjerrja e udhëzimeve, sipas rastit, për të nxitur më tej sjelljen e duhur dhe për të frenuar sjelljen e ndaluar nga politikat dhe programi i Sipërmarrjes;
- g) ushtrimi i vigjilencës së duhur, në bazë të një qasjeje të strukturuar të menaxhimit të riskut, në përzgjedhjen e drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve, si dhe të Partnerëve në Biznes, të cilët paraqesin

rrezik korrupsioni ose shmangie të këtyre Rregullave;

- h) projektimi i procedurave financiare dhe të kontabilitetit për mbajtjen e librave të saktë dhe të duhur, dhe të të dhënave kontabël, për të siguruar se ato nuk mund të përdoren për qëllimin e përfshirjes në, ose fshehjes së praktikave korruptive;
- i) ngritja dhe ruajtja e sistemeve të duhura të procedurave të raportimit dhe kontrollit, duke përfshirë auditimin e pavarur;
- j) duke siguruar komunikim periodik të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me politikën anti-korrupsion të Sipërmarrjes;
- k) udhëzimi dhe trajnimi i dokumentuar i drejtorëve, zyrtarëve, punëmarrësve dhe Partnerëve në Biznes, sipas rastit, për identifikimin e rreziqeve të korrupsionit në transaksionet e përditshme të biznesit të Sipërmarrjes, si dhe trajnim lidhshëm;
- l) përfshirja e rishikimit të kompetencave të etikës së biznesit në vlerësimin dhe promovimin e drejtorëve dhe matja e arritjes së objektivave jo vetëm kundrejt treguesve financiarë, por edhe ndaj mënyrës sesi janë realizuar objektivat dhe specifikisht ndaj përputhshmërisë me politikën anti-korrupsion të Sipërmarrjes
- m) ofrimi i mënyrave për të ngritur problemet në fshehtësi të plotë, për të kërkuar konsulencë ose për të raportuar në mirëbesim ose shkelje të dyshuara në mënyrë të arsyeshme, pa frikën e hakmarrjes ose masës diskriminuese ose disiplinore. Raportimi mund të jetë ose i detyrueshëm, ose vullnetar; ai mund të kryhet në mënyrë anonime ose të hapur. Të gjitha raportimet në mirëbesim duhet të hetohen;
- n) reagimi ndaj shkeljeve të raportuara ose të konstatuara, përmes marrjes së masës së përshtatshme korigjuese dhe masave disiplinore dhe duke pasur parasysh kryerjen e njoftimit të duhur publik të zbatimit të politikës së Sipërmarrjes;
- o) marrjen në konsideratë të përmirësimit të Programit të saj të Përputhshmërisë së Korporatës me anë të kërimit të certifikimit, verifikimit ose garancisë së jashtme; dhe
- p) mbështetja e veprimit të përbashkët, si propozimi ose mbështetja e pakteve anti-korrupsion në lidhje me projekte specifike ose iniciativa afatgjata anti-korrupsion, me sektorin publik dhe/ose kolegët/partnerët në segmentet përkatëse të biznesit.

## Publikime të përzgjedhura të ICC-së

1. Rregullorja e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit e vitit 2011 në anglisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2011/ICC-Rules-on-Corruption/>
2. Rregullorja e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit e vitit 2011 në frëngjisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2011/ICC-Rules-on-Corruption-in-French/>
3. Rregullorja e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit e vitit 2011 në spanjisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2011/ICC-Rules-on-Corruption-in-Spanish/>
4. Udhëzues i ICC-së për Agjentët, Ndërmjetësit dhe Palët e Treta në anglisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2010/ICC-Guidelines-on-Agents,-Intermediaries-and-Other-Third-Parties/>
5. Udhëzues i ICC-së për Agjentët, Ndërmjetësit dhe Palët e Treta në frëngjisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2011/ICC-Guidelines-on-Agents,-Intermediaries-and-Other-Third-Parties-in-French/>
6. Udhëzues i ICC-së për Sinjalizimin në anglisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2008/ICC-Guidelines-on-Whistleblowing/>
7. Udhëzues i ICC-së për Sinjalizimin në frëngjisht:  
<http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Document-centre/2008/ICC-Guidelines-on-Whistleblowing-in-French/>
8. RESIST në anglisht:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>
9. RESIST në frëngjisht:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>
10. RESIST në arabisht:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>
11. RESIST në spanjisht:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>
12. RESIST në gjermanisht:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>
13. RESIST në gjuhën kineze:  
<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>

## Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)

ICC është organizata botërore e biznesit, organ përfaqësues që shprehet me autoritet në emër të sipërmarrjeve nga të gjithë sektorët, në çdo pjesë të botës.

Misioni themelor i ICC është promovimi i tregtisë së hapur dhe investimeve ndërkombëtare dhe asistimi i biznesit në përmbushjen e sfidave dhe mundësive të globalizimit. Bindja e saj se tregtia është një forcë e fuqishme për paqe dhe prosperitet daton që nga origjina e organizatës në fillim të shekullit 20-të. Grupi i vogël i liderëve largpamës të biznesit që themeluan ICC e quajtnë veten "tregtarët e paqes".

ICC kryen tre aktivitete kryesore: përcaktimin e rregullave, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përkrahjen e politikave. Duke qenë se shoqëritë dhe shoqatat e saj anëtare janë të angazhuara vetë në biznesin ndërkombëtar, ICC ka autoritet të pakrahueshëm në përcaktimin e rregullave që rregullojnë sjelljen e biznesit përtej kufijve. Edhe pse këto rregulla janë vullnetare, ato zbatohen çdo ditë në mijëra transaksione të panumërta dhe janë bërë pjesë e rrjetit të tregtisë ndërkombëtare.

ICC gjithashtu ofron shërbime shumë të rëndësishme, më kryesorja është Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit të ICC, institucioni më kryesor në botë për arbitrazh. Një tjetër shërbim është Federata e Dhomave Botërore, rrjeti botëror i ICC-së i dhomave të tregtisë, që nxisin ndërveprimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira të dhomave të tregtisë. ICC gjithashtu ofron trajnime të specializuara dhe seminare dhe është botuesi kryesor i industrisë i materialeve praktike dhe edukative që merren si referencë nga biznesi ndërkombëtar, bankat dhe arbitrazhi.

Liderë dhe ekspertë biznesi të anëtarësuar në ICC shprehim këndvështrime të biznesit për çështje të gjera të politikave të investimeve dhe të tregtisë, si dhe për çështje përkatëse teknike. Këto përfshijnë ndër të tjera çështjet anti-korrupsion, bankare, mbi ekonominë digjitale, etikën e marketingut, mjedisin dhe energjinë, mbi politikën e konkurrencës dhe pronësinë intelektuale.

ICC punon ngushtë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Organizatën Botërore të Tregtisë dhe forumet ndërqeveritare, duke përfshirë G20.

ICC u themelua në 1919. Sot rrjeti i saj global përbëhet nga mbi 6 milionë shoqëri, dhoma tregtie dhe shoqata biznesi në më shumë se 120 shtete. Komitete kombëtare punojnë me anëtarët e ICC në shtetet e tyre për të trajtuar problematikat e tyre dhe për të përcjellë te qeveritë e tyre pikëpamjet e biznesit të formuluar nga ICC.

### INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE

33-43 avenue du Président Wilson, 75116 Paris, France

T +33 (0)1 49 53 28 28 F +33 (0)1 49 53 28 59

E [icc@iccwbo.org](mailto:icc@iccwbo.org)

[www.iccwbo.org](http://www.iccwbo.org)